



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64.2 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, bazuar në vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës Nr.09/2021 i datës 07.01.2021, për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021, nenin 31 të Rregullës Nr.01/2017, për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në SKQZ, si dhe bazuar në vendimin Nr. Nr.13/2021, të datës 07.01.2021, për miratimin e Planit për angazhimin e stafit jo permanent, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 15.01.2021, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit Nr.13/2021, të datës 07.01.2021 për Miratimin e Planit për Angazhimin e Stafit Jo Permanent për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës

- I. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi Nr.13/2021, i datës 07.01.2021, për miratimin e Planit për angazhimin e stafit jo permanent, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me datën 14.02.2021.
- II. Vendimi plotësohet me pikën dhe tekstin si vijon:  
  
**Autorizohet Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ-së, që në kompetencë të tij të vendosë për shtimin e numrit të stafit jo permanent në rast të nevojave të paraqitura për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, në kuadër të mundësive buxhetore.**
- III. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 15.01.2021

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

